

**KOMUNIKATË E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR REZULTATIN  
PËRFUNDIMTAR TË ZGJEDHJEVE PËR DEPUTETËT E KUVENDIT POPULLOR TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në datat 26 maj 1996, 2 qershor 1996 dhe 16 qershor 1996 u kryhen votimet për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë. Në përfundim të këtyre votimeve dhe në bazë të rezultatit të zgjedhjeve të raundit të parë e të dytë në 98 zona elektorale, si dhe të rezultatit të zgjedhjeve në 17 zona elektorale ku u përsëritën votimet e raundsit të parë për shkak të parregullsive serioze në procedurat e votimit dhe në nxjerrjen e rezultatit të votimit u zgjodhën deputetë në Kuvendin Popullor, sipas subjekteve elektorale:

|                                               |               |
|-----------------------------------------------|---------------|
| Për Partinë Balli Kombëtar                    | 1 kandidatë   |
| Për Partinë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut | 2 kandidatë   |
| Për Partinë Demokratike                       | 105 kandidatë |
| Për Partinë Republikane                       | 2 kandidatë   |
| Për Partinë Socialiste                        | 5 kandidatë   |

Gjithashtu, për raundin e parë të zgjedhjeve, në datat 26 maj dhe 16 qershor, u votua edhe për subjektet elektroale që kanë paraqitur listë për mandatet shtesë në shkallë vendi. Nga procesverbalet për rezultatet e zgjedhjeve të 115 zonave elektroale rezultom se 12 subjektet elektorale, që kanë plotësuar kushtet e nenit 15 të ligjit për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, në shkallë vendi kanë fituar numrin e mëposhtëm të votave:

| Subjekti                                 | Vota   | Përqindja |
|------------------------------------------|--------|-----------|
| Patia Aleanca Demokratike                | 25679  | 1.56%     |
| Partia Balli Kombëtar                    | 81822  | 4.97%     |
| Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut | 66529  | 4.04%     |
| Partia Bashkimi Demokrat                 | 11789  | 0.72%     |
| Partia Bashkimi Socialdemokrat           | 32430  | 1.97%     |
| Partia Demokratike                       | 914218 | 55.53%    |
| Partia Demokristiane                     | 21068  | 1.28%     |
| Partia Lëvizja e Legalitetit             | 34019  | 2.07%     |
| Partia Republikane                       | 94567  | 5.74%     |
| Partia Socialdemokrate                   | 25019  | 1.52%     |
| Partia Socialiste                        | 335402 | 20.37%    |
| Partia e Unitetit Kombëtar               | 3939   | 0.24%     |

Në bazë të nenit 11 të ligjit për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, nuk marrin pjwësë në ndarjen e mandateve shtesë subjektet elektorale: Partia Aleanca Demokratike, Partia Bashkimi Demokrat, Partia Bashkimi Socialdemokrat, Partia Demokristiane. Partia Lëvizja e Legalitetit, Partia Socialdemokrate, Partia e Unitetit Kombëtar, të cilat në shkallë vendi nuk kanë mundur të fitojnë më shumë se 4% të votave të vlefshme të hedhura për subjektet elektroale.

Po kështu, në bazë të nenit të mësipërm, 25 mandatet shtesë për deputetët në Kuvendin Popullor u ndahen subjekteve elektorale si më poshtë:

|                                          |            |
|------------------------------------------|------------|
| Partia Balli Kombëtar                    | 1 mandat   |
| Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut | 1 mandat   |
| Partia Demokratike                       | 17 mandate |
| Partia Republikane                       | 1 mandat   |
| Partia Socialiste                        | 5 mandate  |

Përfundimisht, në bazë të rezultatit të zgjedhjeve për kandidatët në zonat njëmëore dhe për mandatet shtesë, në Kuvendin Popullor janë zgjedhur:

|                                               |             |
|-----------------------------------------------|-------------|
| Për Partinë Balli Kombëtar                    | 2 kandidatë |
| Për Partinë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut | 3 kandidatë |

Për Partinë Demokratike  
Për Partinë Republikane  
Për Partinë Socialiste

122 kandidatë  
3 kandidatë  
10 kandidatë

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve njofton të gjithë kandidatët e zgjedhur në zonat njëemërore dhe nga listat shumëemërore të subjekteve elektorale se, në bazë të ligjit për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, ata pajisen me vërtetimin e zgjedhjes përkatësisht nga komisionet e zgjedhjeve të zonave dhe nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe fitojnë të drejtën për të qenë deputetë të Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë. Me mbledhjen e Kuvendit të ri Popullor, secili nga kandidatët e zgjedhur gëzon të drejtën që të pranojë ose të refuzojë mandatin e deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve njofton subjektet elektorale dhe kandidatët për deputetë të paraqitur prej tyre në këto zgjedhje se, në rastet kur vendi i deputetit mbetet bosh për një nga arsyet e përmendura në nenin 80 të ligjit për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, atëherë zëvendësimi i tij bëhet nga Komisioni i Mandateve të Kuvendit Popullor, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 81 të këtij ligji.

Për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

SEKRETARI  
**Kreshnik Spahiu**

KRYETARI  
**Edmir Kapidani**